Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsyesh për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkua siç janë deklaruar.

---

## A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjeter nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:  _____  etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjeter nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:

<p>për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.  Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
---	--

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përbajtjen e kësaj deklarate;	<b>Po [ ]</b>
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	<b>Po [ ]</b>
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	<b>Po [ ]</b>
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	<b>Po [ ]</b>
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përvèç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:	<b>Po [ ]</b>

<p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p>	
<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<b>Po [ ] Jo [ ]</b>
<p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).</p>	<b>Po [ ] Jo [ ]</b>
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<b>Po [ ] Jo [ ]</b>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë,</p>	<b>Po [ ] Jo [ ]</b>

sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	<b>Po [ ] Jo [ ]</b>

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p> <p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksonit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.</li> </ul> <p>Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkyetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku</p>

zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

## D: DEKLARATA

### Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [ ] Jo [ ]

### Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkojen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:  Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje originale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkojen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> <u>Profili i punonjësve</u> <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me të dhënrat konkrete: <hr/>
Data e dorëzimit të deklaratës _____	Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Emri, Mbiemri, Firma \_\_\_\_\_

---

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

*Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

## Shtoja 9

### Formulari i Njoftimit të Skualifikimit<sup>2</sup>

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendor të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit te njoftimit te fituesit sipas parashikimeve të Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tonë të prokurimit.

Me respekt,

#### Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor

<sup>2</sup>Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore

## Shtojca 10

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit:

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

---

<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>Numri i NIPT-it</i>	<i>arsyet e mëposhtme</i>
2._____	_____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>Numri i NIPT-it</i>	<i>arsyet e mëposhtme</i>

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej \_\_\_\_\_ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktiveve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**[Titullari i Autoritetit/entit Kontraktor]**

---

## Shtoja 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 3

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]

Procedura e prokurimit/lotit

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, Sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës] Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_ *Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t* *Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_ *Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *Vlera (e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_ *Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

2. \_\_\_\_\_ *Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra /\_\_\_\_\_] jështë identifikuar si oferta e suksesshme.

---

<sup>3</sup> Ky Formular eshte i aplikueshëm nëse ka Ankime

---

Rrjedhimisht, jeni i latur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: \_\_\_\_\_ (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)

**[Titullari i autoritetit /Entit kontraktor]**

## Shtoje 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHPJEN KUADËR

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

---

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

*arsyet*

2.\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

*arsyet*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1.\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme )

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

2.\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme )

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

Etj.\_\_\_\_\_

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktiveve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**[Drejtuesi i Autoritetit /Entit Kontraktor]**

---

## Shtoja 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT<sup>4</sup>)

[Data]

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. \_\_\_\_\_ Numri i NIPT-it  
*Emri i plotë i shoqërisë*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_  
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

2. \_\_\_\_\_ Numri i NIPT-it  
*Emri i plotë i shoqërisë*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

---

<sup>4</sup> Ky Formulari është i aplikueshëm nëse ka ankime

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1.\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

*arsyet*

2.\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

*arsyet*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1.\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)\_\_\_\_\_

(*e shprehur në shifra dhe në fjalë*)

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

2.\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)\_\_\_\_\_

(*e shprehur në shifra dhe në fjalë*)

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

Etj.\_\_\_\_\_

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqisni tek [*emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor*] sigurimin e kontratës brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Ankesat: (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr dhe datë)\_\_\_\_\_

**[Titullari i Autoritetit /Entit Kontraktor]**

---

### **Sekzioni III Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)**

Ky Seksion përban :

Shtojca 14: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 15: Kushtet e Vecanta të Kontratës

Shtojca 16: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 17: Draftmarreveshja kuadër ku përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 18: Draftmarreveshja kuadër ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

## Shtojca 14

# Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

### Neni 1 Dispozitat e përgjithshme

#### 1.1 Përkuftimet

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

##### 1.1.1 Kontrata

- 1.1.1.1** "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.
- 1.1.1.2** "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.
- 1.1.1.3** "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.
- 1.1.1.4** "Përfundimi" do të thotë përbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
- 1.1.1.5** "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktiveve në Nenin 25.
- 1.1.1.6** "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Mallrave objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
- 1.1.1.7** "Vizatimet" do të thotë vizatimet e Mallrave, siç janë përfshirë në Kontratë, dhe çdo vizatim shtesë dhe i modifikuar i lëshuar nga (ose në emër dhe përllogari të) Blerësit në përputhje me Kontratën.
- 1.1.1.8** "Katalog" do të thotë një "libër" që përmban listën e produkteve/mallrave përfshirë përshkrimet e cilësive/specifikimeve, si dhe mënyrën e përdorimit të tyre.
- 1.1.1.9** "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë. Dokumente të tillë mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.
- 1.1.1.10** "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.
- 1.1.1.11** "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.1.1.12** "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

#### 1.1.2 Palët e Kontratës

---

**1.1.2.1** "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

**1.1.2.2** "Blerës" do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Mallrave objekt kontrate.

**1.1.2.3** "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që furnizon Mallrat objekt kontrate.

**1.1.2.4** "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për ofrimin e një pjese të Mallrave ose Shërbimeve të Lidhura me to.

**1.1.3 Datat, Testet, Periudhat dhe Përfundimi**

**1.1.3.1** "Test i Pranimit" do të thotë testet (nëse janë të aplikueshme) të cilat janë specifikuar në Kontratë dhe që kryhen në përputhje me Specifikimet për qëllimin e pranimit të Mallrave.

**1.1.3.2** "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

**1.1.4 Mallrat**

**1.1.4.1** "Mallra" do të thotë të gjitha mallrat, lënda e parë, makineritë dhe pajisjet dhe / ose materialet e tjera që Furnizuesit duhet t'i furnizojnë Blerësit sipas Kontratës.

**1.1.4.2** "Shërbime të Lidhura" do të thotë shërbimet e rastit të lidhura me furnizimin e Mallrave, siç janë sigurimi, transporti, instalimi, vënia në punë, trajnimi dhe mirëmbajtja fillestare ose ndonjë shërbim tjetër i kësaj natyre sipas Kontratës.

**1.1.5 Përkufizime të tjera**

**1.1.5.1** "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

**1.1.5.2** "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 22 "Forca Madhore".

**1.1.5.3** "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 10 "Sigurimi i Kontratës".

**1.1.5.4** "Vendi i dorëzimit të Mallrave", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

**1.1.5.5** "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

**1.1.5.6** Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 23.

**1.1.5.7** "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe përzbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK

**1.1.5.8** "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

**1.2 Interpretimi**

**1.2.1** Interpretimi i Kontratës, përvëç kur konteksti kërkon ndryshe:

- 
- (a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
  - (b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;
  - (c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
  - (d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

#### **1.2.2 Inkoterma**

- (a) "Inkoterma" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- (b) Përveçse kur nuk është në përputhje me ndonjë dispozitë të Kontratës, kuptimi i çdo termi tregtar dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve në të do të jenë siç përshkruhet nga Inkoterma.
- (c) Inkoterma, kur përdoren, rregullohen nga rregullat e përshkruara në botimin aktual të Inkotermave, të specifikuara në KVK, dhe të publikuara nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

#### **1.2.3 Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

#### **1.2.4 Heqja dorë**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

#### **1.2.5 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës**

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

### **1.3 Komunikimet**

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënen ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimave, njoftimeve, kërkeseve dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlgim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlgimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsyë.

### **1.4 Ligji dhe gjuha**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislativit Shqiptar në fuqi.

---

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjeter me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruar nga Furnizuesi.

## **1.5 Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

## **1.6 Hartimi i Kontratës**

**1.6.1** Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

**1.6.2** Ekzistenza e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

## **1.7 E drejta e autorit**

**1.7.1** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha vizatimet, dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtëpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

## **1.8 Detaje Konfidenciale**

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkojen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përpunje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Mallrave të përgatitura nga Pala tjeter pa marrëveshjen paraprake të Palës tjeter. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

## **1.9 Pajtueshmëria me ligjet**

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tillë i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbrushjen e detyimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

---

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës 1.9 (a) këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cenuar Nenin 7.1.

#### **1.10 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të janë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përbushjen e dispozitave të Kontratës.

#### **1.11 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 2 Praktikat e Ndaluara**

- 2.1** Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.
- 2.2** Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfiktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

#### **Neni 3 Njoftimet**

- 3.1** Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.
- 3.2** Njoftimi do të ketë efekt apo të dorëzohet.

#### **Neni 4 Objekti i Furnizimit**

- 4.1** Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të furnizohen duhet të janë sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.
- 4.2** Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsyе objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

#### **Neni 5 Dorëzimi**

- 
- 5.1** Dorëzimi i Mallrave dhe Përfundimi i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

#### **Neni 6 Përgjegjësitë e Furnizuesit**

- 6.1** Furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e të gjitha Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në Objektin e Furnizimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

#### **Neni 7 Çmimi i Konratës**

- 7.1** Çmimi i konratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Konratës, përvèç rasteve të parashikuara në Nenin 21.

#### **Neni 8 Kushtet e Pagesës**

- 8.1** Çmimi i Konratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.

Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Mallrat e dorëzuara dhe Shërbimet e Lidhura me to të kryera, në përbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Konratë.

- 8.2** Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.

- 8.3** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njofteimit të konratës.

- 8.4** Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e konratës, detyrimet e prapambeturë dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

#### **Neni 9 Tatimet, Taksat dhe Detyrimet e tjera**

- 9.1** Për Mallrat e produhuara jashtë vendit të Blerësit, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, taksat e pullës, tarifat e licencës dhe detyrime të tjera të tillë të vendosura jashtë vendit të Blerësit.

- 
- 9.2** Për Mallrat e produara brenda vendit të Blerësit, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, detyrimet, tarifat e licencës, etj., të lindura deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara tek Blerësi.
- 9.3** Nëse në vendin e Blerësit, mund të jetë i disponueshëm për Furnizuesin ndonjë përjashtim, ulje, lejim ose favor tatimor, Blerësi duhet t'i krijojë mundësi Furnizuesit të përfitojë nga këto lehtësira.

#### **Neni 10 Sigurimi i Kontratës**

- 10.1** Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.
- 10.2** Në përputhje me Nenin 10.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.
- 10.3** Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.
- 10.4** Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përvèç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

#### **Neni 11 Nënkontraktimi**

- 11.1** Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.
- 11.2** Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit
- 11.3** Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

#### **Neni 12 Specifikimet dhe Standardet**

- 12.1** Furnizuesi duhet të sigurojë që Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura të jenë në përputhje me Kërkeshat Teknike, siç specifikohet në Dokumentet e Tenderit.

Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjeter të specifikimeve teknike të dhëna nga Blerësi, me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Furnizuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Blerësin për të.

